



Datë: 30.01.2026
Numër Protokoll: 528/2026

A.nr.2021/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj dhe Malsore Gashi Bajraktari Demi, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2021/2025, të datës 12.12.2025 të parashtruar nga ankuesja D.Gj, kundër organit të punësimit: Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.2021/2025 e datës 12.12.2025 e parashtruar nga ankuesja D.Gj.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. DE 11778/2025, i datës 24.11.2025 i Ushtruesit të Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare për Privatizim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile D.Gj (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), më datë 12.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. DE 1178/2025/2025, të datës 24.11.2025 të Ushtruesit të Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare për Privatizim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.12.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Privatizim, ndërsa kjo e fundit më datë 15.01.2026 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7852/2025, të datës 12.12.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për parashtrimin e ankesës të datës 12.12.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankesës të D.GJ; Vendimin me numër protokolli Nr.1538/2020 të datës 23.09.2020; Letër rekomandimin me numër protokolli Nr.369/2020 të datës 24.02.2020; Raportin Mjekësori datës 09.12.2025; Vendimin me numër DE 1178/2025 të datës 21.11.2025; E-mailin e datës 24.11.2025; E-mailin e datës 21.11.2025; E-mailin e datës 12.12.2025; Kërkesën për përgjigje të datës 19.12.2025; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2021/2025 të datës 15.01.2026; Rregulloren Nr.05/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të datës 04.09.2023; Organogramin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit; Akt emërimit me numër Ref.193/DP2 , të datës 16.10.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës Zyrtar i Prokurimit; Akt emërimit me numër Reference 194/DP1 të datës 24.10.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës “Udhëheqës i divizionit të prokurimit”; Vendimin me numër De1166/2025 të datës 06.11.2025 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të moshës së pensionimit të nëpunësit M.P; Aktin e emërimit me numër Reference 196/DP 3 të datës 16.10.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë”.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit konstatoi se ankesa **është e pabazuar, sepse:**

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 16.10.2023 është e punësuar në pozitën Zyrtare e Prokurimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Tutje sipas vendimit me NR.DE1166/2025 të datës 06.11.2025 të Kreshefit Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nëpunësit M.P i është përfunduar marrëdhënia e punës me rastin e arritjes së moshës së pensionimit nga data 22.11.2025, për shkak të volumit të madhe të punëve dhe vazhdimit normal të procesit në divizionin e Prokurimit , si dhe në interes të institucionit, Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me Vendimin me Nr. DE 1178/2025 të datës 21.11.2025, zyrtaren M.Z e ka emëruar ushtrues të detyrës së Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit për periudhë një vjeçare.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me Nr. DE1178/2025, të datës 24.11.2025 të Ushtruesit të Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pretendon se vendimi i lartë cekur është në kundërshtim me nenin 5 nenin 8 dhe nenin 10 të Ligjit NR.08/L197 për Zyrtar Publik, pasi që Kryeshiefi Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk e ka marrë parasysh përvojën me të gjatë profesionale dhe kualifikimet e ankueses.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, analizoi legjislacionin e aplikueshëm në ndërlidhje me çështjen e emërimit të përkohshëm të ushtruesit të detyrës, gjegjësisht dispozitat e Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 35 paragrafit 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit, dhe nenit 9*

paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet: *1. Paragrafi 1. i nenit 35 të ligjit bazik ndryshohet si në vijim: 1. Në rast se një pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësi i nivelit të lartë drejtues i atij institucioni e cakton me vendim ushtruesin e detyrës për pozitën e lirë. Për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, ushtruesin e detyrës e cakton titullari, dhe si rrjedhojë duke u bazuar në kuadrin ligjor si me lartë dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, gjegjësisht Akt emërimit të datë 16.10.2023 të ankueses, si dhe Akt emërimit të datës 16.10.2023 të zyrtares M.Z, konstatohet fakti se edhe ankuesja edhe zyrtarja M.Z, mbajnë pozita të njëjtë të së njëjtës kategori por jo edhe te njëjtës klasë sepse kandidatja M.Z sipas aktit të emërimit është profesional 1 ndërsa ankuesja profesional 2, në këtë aspekt akti i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi me Nr. DE1178/2025, i datës 24.11.2025 i Ushtruesit të Detyrës së Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë Kosovare për Privatizim për caktimin e nëpunëses M.Z si ushtruese detyrës së Udhëheqëses së Divizionit të Prokurimit, është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në pajtim me dispozitat e cekura si më lartë.*

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.2021/2025

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, D.Gj;
- Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në Agjencinë e Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.